



Periodik mujor Nr. 166 Mars 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

AMF zgjeron bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin Mbikëqyrës të Luksemburgut

03

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar- Shkurt 2023

04

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

05-10

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

11-13

AMF zgjeron bashkëpunimin me rregullatorët evropianë, Memorandum Mirëkuptimi me Autoritetin Mbikëqyrës të Luksemburgut (CSSF)



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Komisioni i Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Luksemburgut (CSSF) nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në kuadër të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit mes dy rregullatorëve. Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete dhe Drejtori Ekzekutiv i CSSF-së, z. Claude Marx.

Marrëveshja përcakton një kuadër të qartë bashkëpunimi mes dy rregullatorëve financiarë, sipas fushave ku ata ushtrojnë funksionet mbikëqyrëse, tregun e kapitaleve, tregun e fondeve të investimeve dhe fondet private të pensioneve. Synimi i Memorandumit të Mirëkuptimit është vendosja e urave të bashkëpunimit mes dy autoriteteve mbikëqyrëse, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, promovimit të integritetit, stabilitetit dhe eficiencës në tregjet nën mbikëqyrje përmes konsultimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mes dy autoriteteve mbikëqyrëse.

AMF udhëheq negociatat për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare” dhe në këtë kuadër, zgjerimi i bashkëpunimit me rregullatorët evropiane, përveç shkëmbimit të informacionit, shërben për të përfituar nga eksperiencia dhe asistenca e tyre në funksion të përafrimit me legjislacionin e BE-së, si edhe avancimit drejt praktikave më të mira mbikëqyrëse.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar – Shkurt 2023

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shkurt 2023 kapën vlerën 3,297 milionë lekë, ose 19.07% më shumë se në janar-shkurt 2022. Gjatë periudhës janar-shkurt 2023, numri i kontratave të lidhura të sigurimit arriti në 187,030 me një rritje prej 13.06% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.59% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.41%.

Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 43.48% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 56.52% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 1,080 milionë lekë, ose 27.76% më shumë se në periudhën janar-shkurt 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-shkurt 2023 kapën vlerën 752 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 20.76% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Shkurt 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë muajve Janar-Shkurt 2023 arritën rreth 1,863 milionë lekë, ose 8.38% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren "Mbi ndalimin e abuzimit me tregun"



Faqe Kryesore ▶ Legjislacioni ▶ Projektakte ▶ Projektregullore

Projektregullore "Mbi ndalimin e abuzimit me tregun"

Projektregullore "Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në një vend anëtar të BE-së"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren "Mbi ndalimin e abuzimit me tregun".

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=88>

**Kuvendi i Shqipërisë voton z. Ildir Gjata
anëtar të Bordit të AMF-së**



Kuvendi i Shqipërisë miratoi më datë 16 mars 2023 në seancë plenare emërimin e Z. Ildir Gjata si anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Kandidatura e Z. Ildir Gjata ishte propozim i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

AMF zhvillon aktivitet për edukimin financiar - përfundon konkursi i bursës për studentët, *Stock Market Learning Competition, 2023*



Tiranë, 29 mars 2023 – Ceremonia përmbyllëse e konkursit “Të mësojmë për bursën” - *Stock Market Learning Competition, 2023*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me *German Sparkassenstiftung Albania* organizuan aktivitetin përmbyllës të konkursit “Të mësojmë për bursën” - *Stock Market Learning Competition, 2023*. Ky aktivitet i shërben nxitjes së edukimit financiar të studentëve për tregun e kapitalit, një nga tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së. Ky është viti i dytë që AMF bashkëpunon për zhvillimin e këtij aktiviteti me studentët e fakulteteve ekonomike të universiteteve të vendit. 40 skuadra studentore, nga 18 universitete të ndryshme në vend, si edhe nga Universiteti i St. Kliment Ohridski nga Maqedonia e Veriut morën pjesë në këtë konkurs.

Duke përshëndetur këtë aktivitet, Zj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoare Ekzekutive e AMF-së, vlerësoi angazhimin e të rinjve për të thelluar njohuritë e marra gjatë studimeve universitare për tregjet e kapitalit. Ajo theksoi “... se tregtimi në bursën virtuale është një fillim i mirë në rrugëtimin e karrierës suaj profesionale dhe një investim i rëndësishëm për të ardhmen tuaj. Kam bindjen se studentët kanë kuptuar ndryshimin midis kursimit dhe investimit, rëndësinë e diversifikimit të portofolit financiar, si dhe kanë arritur të përmirësojnë aftësitë e tyre analitike gjatë tregtimit në bursën virtuale. Jeni pikërisht ju, studentët, lojtarët e vërtetë të së ardhmes që mund të nxisni kërkesën dhe ofertën për instrumente financiare, pra të vitalizoni tregjet e kapitalit.”

AMF zhvillon aktivitet për edukimin financiar, përfundon konkursi i bursës për studentët – Stock Market Learning Competition, 2023

... vijon



Zj. Mimoza Kaçi, përcolli përpara pjesëmarrësve në takim aktivitetet e AMF-së për edukimin financiar dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për finalizimin e një dokument strategjik me plane konkrete për zhvillimin e tregut të kapitalit në vend.

AMF ka përmirësuar ndjeshëm kuadrin rregullator për tregun e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive. Njëkohësisht, AMF ka hartuar projektligjin “Për fondet e pensionit privat”, në përputhje me direktivën evropiane IORP II, i cili do të nxisë zhvillimin e këtij segmenti të tregut financiar.

Takimi u përshëndet edhe nga z. Paul Kriews, Menaxher i Projektit nga German Sparkassenstiftung Gjermani, i cili duke i uruar studentët, vlerësoi njohuritë që ata morën për të bërë lidhjen midis biznesit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ai i uroi studentët shqiptarë që morën pjesë në këtë konkurs, krahas 100,000 pjesëmarrësve të tjerë.

Zj. Zamira Gjini, Drejtore e Përgjithshme e Politikave në Ministrinë e Arsimit, përgëzoi studentët e organizatorët, si edhe theksoi vëmendjen që i kushtohet përfshirjes së edukimit financiar në kurrikulat shkollore në nivelin parauniversitar dhe rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve për këtë qëllim.

Përgjatë tre muajve të konkursit, skuadrat u pajisën me fonde virtuale dhe i investuan ato në tituj, sipas çmimeve reale të tregtimit në tregjet financiare ndërkombëtare. Vlerësimi përfundimtar u bazua në dy kriterë: vlera dhe qëndrueshmëria në portofolin investues, duke vlerësuar gjashtë skuadra studentore me çmimet promovuese. Skuadrat e studentëve të Universitetit Luarasi dhe Universitetit të New York në Tiranë, morën çmimet e para në këto dy kategori.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë aktivitetet për nxitjen e edukimit dhe gjithëpërfshirjes financiare, si ndër objektivat kryesorë të tij.




Skuadra fituese e studentëve të Universitetit Luarasi



Skuadra fituese e studentëve të Universitetit të New York në Tiranë

Moody's: high inflation is the greatest concern for European insurance CFOs

9 March 2023 – Marina MAGNAVAL



Moody's: inflacioni i lartë është shqetësimi më i madh për CFO-të evropianë të sigurimeve

Sipas anketës vjetore të zhvilluar nga Moody's me drejtues të lartë financiarë (CFO) nga 22 sigurues kryesorë evropianë, inflacioni mbetet një shqetësim kryesor për CFO, sidomos edhe pas perspektivës ekonomike të dobët dhe të paqëndrueshme të tregut në 2023. Sondazhi zbuloi se siguruesit po ndryshojnë planet e tyre të investimeve dhe po përdorin kapitalin e tepërt në përgjigje të rritjes së normave dhe paqëndrueshmërisë së tregut. Perspektivat e agjencisë lidhur me sigurimin e pronës dhe *kazualitetet* (*P&C insurance*, e njohur edhe si sigurimi i përgjithshëm) dhe sigurimin e Jetës janë respektivisht negative dhe të qëndrueshme. Megjithatë të anketuarit ishin më optimistë në lidhje me operacionet e tyre P&C.

Sipas gjetjeve të sondazhit, inflacioni i vazhdueshëm është kërcënimi kryesor, me 73% të të anketuarve që e vendosin atë në tre shqetësimet e tyre kryesore. Sondazhi zbuloi gjithashtu se rreth dy të tretat e CFO-ve renditën rritjen e ulët ekonomike si shqetësimin e tyre të dytë më urgjent, të ndjekur nga paqëndrueshmëria e tregut. "Megjithatë, rreth 41% parashikojnë rritje të lartë njëshifrore ose dyshifrore në rezultatet e tyre të punës. Zyrtarët e financave janë optimistë se rezultatet më të forta të investimeve dhe rritja e biznesit të ri, veçanërisht në linjat Jo-Jetës, do të mbështesin fitimet e tyre", shprehet agjencia Moody's.

Moody's: inflacioni i lartë është shqetësimi më i madh për CFO-të evropiane të sigurimeve

... vijon

Gjetja e tretë kryesore e sondazhit është se siguruesit po rregullojnë planet e tyre të investimeve. Kjo është për shkak të normave më të larta dhe erërave të kundërta ekonomike, të cilat kanë ulur oreksin e të anketuarve për investime me rrezik më të lartë. Shumica e CFO-ve presin që ekspozimi i tyre ndaj këtyre aseteve të mbetet i qëndrueshëm. Agjencia tha se krahasuar me sondazhin e mëparshëm, më shumë të anketuar planifikojnë të reduktojnë investimet e tyre në pasuri të paluajtshme. Në të njëjtën kohë, më shumë sigurues presin të rrisin alokimin e tyre ndaj obligacioneve të vlerësuara me Baa, ndërkohë që reduktojnë ekspozimet e tyre në klasën e nën-investimit.

Sondazhi i Moody's më në fund zbuloi se vëmendja e CFO po kthehet te shpërndarja e kapitalit, me gjysmën e të anketuarve që thanë se planifikojnë të shpërndajnë kapital të tepërt në vitin 2023 - nga 29% në anketën e mëparshme të Moody's. Kjo reflekton përmirësimin e aftësisë paguese si rezultat i rritjes së normave. "Preferenca e CFO-ve është të kanalizojnë tepërcën në aftësi të reja biznesi ose shpërndarjeje, në vend të *M&A (Merge and Acquisition)* dhe/ose t'u kthejnë kapitalin investitorëve. Të anketuarit nuk planifikojnë emetim borxhi që tejkalon nevojat për rifinancim, duke reflektuar norma më të larta dhe një rritje të madhe në matjet e levës në vitin 2022", shprehet agjencia Moody's.

Artikulli: "Moody's: high inflation is the greatest concern for European insurance CFOs" gjendet në:

<https://www.xprimm.com/Moody-s-high-inflation-is-the-greatest-concern-for-European-insurance-CFOs-articol-117,149-20168.htm>

BULLGARI

www.xprimm.com

Duke iu referuar informacioneve nga Banka Qendrore e Bullgarisë, deri në fund të dhjetorit 2022, aktivet e menaxhuara nga kompanitë bullgare të sigurimit arritën në rreth 9.64 miliardë BGN, ose rreth 4.9 miliardë euro. Kjo shifër paraqet një rënie prej 4.8% në krahasim me vitin e kaluar.

Asetet e shoqërive të Jo-Jetës ranë me 0.4% duke arritur në rreth 6.98 miliardë BGN në fund të vitit 2022, ndërsa asetet e menaxhuara nga siguruesit e Jetës ranë me 14.5% duke arritur në 2.66 miliardë BGN. Asetet e shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës përbënin 72.4% të totalit të sektorit, duke u rritur me 69.3% krahasuar me vitin 2021.

Letrat me vlerë përbënin 46.6% të të gjitha aktiveve të shoqërive të sigurimit në fund të dhjetorit nga 44.3% që ishin ato një vit më parë.

Numri i kompanive të sigurimeve aktive në Bullgari ka rënë në 44 në fund të dhjetorit 2022, nga 49 që ishte në fund të vitit 2021.

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut për tremujorin e katërt 2022 të publikuara nga AZOBIH - Agjencia e Sigurimeve të Bosnjës dhe Hercegovinës, në fund të vitit të kaluar, tregu i sigurimeve në Bosnje arriti në 450.5 milionë euro, ose 881 milionë BAM (monedha lokale). Kjo shifër është 7.7% më shumë në krahasim me vitin 2021.

Vlera e primeve të shkruara bruto të siguruesve që operojnë në Federatën e Bosnje-Hercegovinës u rrit me 7.5% duke arritur në 314.7 milionë euro. Ndërsa siguruesit me bazë në Republikën Serbe të Bosnjës gjeneruan 135.8 milionë euro, shifër 8.1% më shumë se një vit më parë.

Për sa i përket dëmeve të paguara nga siguruesit, shuma e përgjithshme u rrit me 15% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 204 milionë euro. Pjesën më të madhe të pagesave të dëmeve e zinin dëmet e Jo-Jetës me rreth 150 milionë euro pagesa, ndërsa pagesat nga kontratat e sigurimit të Jetës zinin rreth 54 milionë euro.

Në fund të vitit 2022, primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 7.6% krahasuar me 2021 duke arritur në 354.2 milionë euro ose 692.8 milionë BAM. Ndërsa primet në segmentin e sigurimeve të Jetës u rritën me 7.7% duke arritur në 96.3 milionë euro ose 188.2 milionë BAM.

Nga sigurimet e Jo-Jetës, shumat më të mëdha të primeve të shkruara bruto i korrespondonin dy linjave të sigurimit motorik - MTPL me 218.3 milionë euro, sigurimi Kasko me 45.9 milionë euro, si edhe sigurimi i pasurisë me 36 milionë euro.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fund vitit të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, CNB, në fund të vitit 2022, tregu çek i sigurimeve arriti në 200 miliardë CZK ose rreth 8.3 miliardë euro, me 11.3% rritje krahasuar me vitin 2021. Për tregun e sigurimit të Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto (përfshirë edhe risigurimin) u rrit me 5% krahasuar me 2021, ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 13.9%.

Dëmet e paguara nga siguruesit vendas arritën në 117 miliardë CZK ose rreth 4.8 miliardë euro duke shënuar një rritje me 14.7 % krahasuar me shifrat e vitit 2021. Vlera e 69.8 miliardë CZK dëme të paguara lidheshin me sigurimet e Jo-Jetës, ndërsa pjesa e mbetur prej 47.2 miliardë CZK lidhet me nënklasat e sigurimit të Jetës.

Rreth një muaj më parë, shifrat e fund vitit të publikuara nga Shoqata Çeke e Sigurimeve, CAP, treguan se në fund të vitit 2022 vëllimi i primeve të shkruara bruto i raportuar nga kompanitë anëtare arriti në 157.36 miliardë CZK ose rritje me 6.52 miliardë euro, rreth 7.01%. Segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 3.17% krahasuar me vitin e kaluar duke arritur në 49.77 miliardë CZK ose 2.06 miliardë euro. Ndërsa primat e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 8.89%.

KOSOVË

www.xprimm.com

Siç treguan shifrat mujore zyrtare të publikuara në faqen e Bankës Qendrore e Kosovës, gjatë vitit 2022 vëllimi i primeve të shkruara bruto në krahasim me viti 2021 u rrit me 14.14% duke arritur në 134. milionë euro, ndërsa totali i dëmeve bruto të paguara u rrit me 5.41% duke arritur në 64.3 milionë euro.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës arritën në 127.72 milionë euro, nga 114.33 milionë euro gjatë vitit 2021, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën në 6.4 milionë euro nga 4.90 milionë euro.

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, asetet e kompanive kosovare të sigurimeve u rritën në 267.5 milionë euro më 31 dhjetor 2022, nga 238.9 milionë euro një vit më parë.

Shifrat përfshijnë të dhënat për 12 kompani të sigurimit që operojnë në Kosovë, 10 - sigurues të Jo-Jetës dhe dy kompani të sigurimit të Jetës.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, ISA, tregu i sigurimeve në vend raportoi një rritje vjetore të primeve të shkruara bruto prej 9.58% në fund të vitit 2022, duke arritur në 108.28 milionë euro.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës, i cili zë rreth 80.26% të vëllimit total të primeve të sigurimit realizoi vlerën e 86.91 milionë euro, ndërsa sektori i sigurimeve të Jetës realizoi 21.37 milionë euro. Në vlera absolute tregu malazez u rrit me një vlerë prej 9.5 milionë euro prime të shkruara bruto, nga të cilat 1.6 milionë euro u regjistruan në sigurimet motorike MTPL.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave analitike të sektorit financiar për vitin 2022, të publikuar nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, NBS, tregu sllovak i sigurimeve arriti në 1.92 miliardë euro, ose 4.7% më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas është rritur me 15.5% në terma vjetorë duke arritur në 1.18 miliardë euro, nga të cilat 583.9 milionë euro kanë të bëjnë me dëmshpërblimet e sigurimit të Jetës, 176.9 milionë euro lidhet me sigurimet motorike MTPL, 183.4 milionë euro – sigurimet Kasko dhe 159.7 milionë euro – ishin pagesa në lidhje me dëmshpërblimet e pronës.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jetës u rrit me 1.2% në terma vjetorë, duke arritur në 795.7 milionë euro. Sigurimet e Jetës gjenerojnë 41.3% të totalit të tregut të sigurimeve. Ndërsa klasat e sigurimeve të Jo-Jetës, të cilat zënë rreth 58.7% të totalit të primeve të shkruara bruto, u rritën me 7.3% më shumë krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 1.13 miliardë euro.

Sipas të dhënave tremujore të tregut të publikuara nga Shoqata Sllovaqe e Sigurimeve, SLASPO, në fund të vitit 2022, vëllimi i primeve të shkruara bruto nga të gjithë anëtarët e shoqatës arriti në 2.60 miliardë euro, duke u rritur me 4.50% krahasuar me një vit më parë.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, TSB, në fund të vitit 2022, sektori i sigurimeve në vend u rrit me 123.2% duke arritur në 235 miliardë TRY ose rreth 11.8 miliardë euro. E shprehur në monedhën evropiane, për shkak të diferencave të kursit të këmbimit, ndryshimi i tregut ishte një rritje me 69% në vit.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimit të Jetës u rrit me 74% krahasuar me vitin 2021, duke arritur në 30.9 miliardë TRY. Ndërsa për sigurimet e Jetës, vëllimi i primeve u rrit ndjeshëm me më shumë se 133% krahasuar me vitin 2021, duke arritur në 204.1 miliardë TRY. Rritja më e madhe është vërejtur në dy nënklasat e sigurimeve motorike, sigurimi Kasko, i cili u rrit me 211.5% , sigurimi MTPL u rrit me 147% dhe sigurimet shëndetësore u rritën me 130%.

Shoqata e Sigurimeve të Turqisë ka 64 anëtarë aktivë.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al